



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Drejtoria e Përgjithshme



Nr. 3946 Prot.

Tiranë, më 23.07. 2021

U D H Ë Z I M

Nr. 03, datë 23.07. 2021

PËR

“LIDHJEN E KONTRATAVE ME FARMACITË DHE AGJENCITË
FARMACEUTIKE ”

Në zbatim të ligjit nr. 10383 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124 datë 05.03.2014 “Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” i ndryshuar, vendimit nr.71, datë 22.12.2015 të Këshillit Administrativ të FONDI-it “Për kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratës me FOND-in dhe procedurat për lidhjen e kontratave”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 13, datë 19.07.2021 të Këshillit Administrativ të FOND-it “Për miratimin e kontratave me subjektet farmaceutike”;

U D H Ë Z O J:

1. Kontratat, për rimbursimin e Farmacive dhe Agjencive farmaceutike për vitin 2021, hyjnë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të listës së re të barnave të rimbursuara.
2. Drejtoritë Rajonale, të krijojnë dosje të veçantë për çdo Farmaci dhe Agjenci farmaceutike, që fillojnë procedurën për lidhjen ose rilidhjen e kontratës 2021, bazuar në kërkesën e protokolluar pranë Drejtorisë Rajonale.
3. Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, të cilat janë të kontraktuara, për rilidhjen e kontratës, duhet të plotësojnë kriterin e largësisë: *“Farmacia që lidh kontratë me Fondin, duhet të ketë hyrjen e saj në një distancë të paktën 20 m, nga kufiri i jashtëm i institucionit shëndetësor publik”*.
4. Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit në rajonin, ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të listës së re të barnave të rimbursuara, dokumentacionin si më poshtë vijon:
 - a. Formularin Tip, të vetëdeklarimit (të shkarkohet nga adresa elektronike: fsdksh.gov.al).

- b. Inventarin e barnave, të printuar nga sistemi i recetës elektronike eRx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.
 - c. Inventarin e barnave, të skaduara, (nëse ka), të printuar nga sistemi eRx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.
 - d. Vetëdeklarimin, që farmacia ka hyrjen e saj, në një distancë të paktën 20 m nga kufiri i jashtëm i institucionit shëndetësor publik, të shoqëruar me genplanin/planvendosjen e objektit, që vërteton distancën.
5. Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat janë të kontraktuara, për rilidhjen e kontratës së tyre të dorëzojnë fotokopje të dokumentit të kriterit të ndryshuar në rastet kur ka ndryshuar njërin nga kriteret e kontraktimit si më poshtë vijon:
- a. Licencën e aktivitetit
 - b. Pronari i aktivitetit
 - c. NIPT-in
 - ç. Drejtuesi teknik
 - d. Farmacistë ose ndihmësfarmacistë të punësuar
6. Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat kanë qenë të kontraktuara, por që u është zgjidhur kontrata për një periudhë kohe më pak se 1 (një) vit, për të lidhur kontratën, të dorëzojnë:
- a. Vetëdeklarimin që farmacia, ka hyrjen e saj, në një distancë të paktën 20 m nga kufiri i jashtëm i institucionit shëndetësor publik, të shoqëruar me genplanin/planvendosjen e objektit që vërteton distancën.
 - b. Formularin tip, të vetëdeklarimit *(të shkarkohet nga adresa elektronike: fsdksh.gov.al)*. Të dhënat, të përputhen, me të dhënat e deklaruara në QKB.
 - c. Kopjen e licencës së ushtrimit të aktivitetit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
 - d. Kopjen e certifikatës së regjistrimit tatimor, NIPT/NUIS, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit-QKB.
 - e. Kopjen e certifikatës së ushtrimit të profesionit, për drejtuesin teknik, të lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
 - f. Kopjen e kontratës së punës, ndërmjet punëdhënësit/punëmarrësit, (pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarin, farmacistë apo dhe nd/farmacistë).
 - g. Kopjen e certifikatës së anëtarësimit, të lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, të kërkohet (pranohet), vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (origjinali).
 - h. Vërtetimin e lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve, në rastet e skadimit të certifikatës së Urdhrit të Farmacistëve, (të pranohet, vërtetimi origjinal), i lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve, për farmacistët dhe ndihmësfarmacistët e punësuar deri në pajisjen e tyre me certifikatën e re.
 - i. Inventarin e barnave, të printuar nga sistemi i recetës elektronike e-Rx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.

- j. Inventarin e barnave të skaduara, (nëse ka), të printuar nga sistemi e-Rx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.

7. Drejtoritë Rajonale, në rastet kur kontrata është zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ana e farmacistë, nuk rilidhin kontratë me farmacistë, jo më shpejt se, një periudhë kohore 1 (një) vjeçare nga koha e zgjidhjes së kontratës.

FARMACITË DHE AGJENCITË FARMACEUTIKE, TË CILAT LIDHIN KONTRATË PËR HERË TË PARË

Kontrata, për herë të parë me Fond-in, konsiderohet në rastet kur:

- a. Farmacia dhe agjencia farmaceutike, hyn në skemën e sigurimeve shëndetësore, për herë të parë, pa patur asnjëherë kontratë të mëparshme me Fond-in.
- b. Farmacia dhe agjencia farmaceutike ka kontratë me Fondin, por ndryshon në të njëjtin moment NIPT/NUIS, licencën e aktivitetit, pronarin dhe drejtuesin teknik.
- c. Farmacia dhe agjencia farmaceutike ka patur kontratë, por i është zgjidhur për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- d. Farmacia dhe agjencia farmaceutike ka patur kontratë, por ndryshon vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.
- e. Farmacia ndryshon aktivitetin e saj, nga agjenci farmaceutike në farmaci.

8. Farmacistë dhe Agjencitë farmaceutike, të drejtohen me kërkesë me shkrim, pranë FOND-it, dhe të dorëzojnë dokumentacionin sipas, gërmave a, b, c, g dhe h (më poshtë). Vetëm pasi kanë marrë miratimin nga ana e FOND-it, farmacistë/agjencitë farmaceutike, duhet të dorëzojnë brenda 15 ditësh pranë Drejtorisë Rajonale të rajonit ku ushtrojnë aktivitetin e tyre dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a. Formularin tip të vetëdeklarimit, (të shkarkohet nga adresa elektronike: fsdksh.gov.al). Të dhënat duhet të përputhen me të dhënat e deklaruara në QKB.
- b. Kopjen e licencës, së ushtrimit të aktivitetit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
- c. Kopjen e certifikatës, së regjistrimit tatimor, NIPT/NUIS, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB.
- d. Kopjen e certifikatës, së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik, të lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- e. Kopjen e kontratës së punës, ndërmjet punëdhënësit/punëmarrësit, (pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarin, farmacistë apo dhe nd/farmacistë).
- f. Kopjen e certifikatës së anëtarësimit, të lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, të kërkohet (pranohet), Vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (originali).
- g. Genplanin apo planimetrinë e mjedisit, mbi 50 m² për farmacistë dhe 15 m² agjencia farmaceutike, të lëshuar nga një arkitekt, inxhinier i licencuar.
- h. Plan vendosjen, të lëshuar nga një arkitekt, inxhinier i licencuar, ku:

- ✓ distanca/largësia e farmacisë/agjencisë të jetë mbi 150 metra (rrugë këmbësore) nga farmacitë apo agjencitë ekzistuese me kontratë;
 - ✓ distanca/largësia e farmacisë të jetë, mbi 20 metra nga kufiri i jashtëm i institucionit shëndetësor publik (*nuk aplikohet për agjencitë farmaceutike*).
- i. Inventarin e barnave, të printuar nga sistemi i recetës elektronike e-Rx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.
 - j. Inventarin e barnave të skaduara, (nëse ka), të printuar nga sistemi e-Rx në datën 01.08.2021, para fillimit të aktivitetit.

9. Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, gjatë periudhës që janë të kontraktuar, rezultojnë se, duan të ndryshojnë vendndodhjen e tyre, duhet të plotësojnë dhe përmbushin, kriteret e sipërfaqes dhe të largësisë. Për këtë arsye, farmacitë dhe agjencitë farmaceutike duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit dokumentacionin si më poshtë vijon:

- a. Kërkesën me shkrim, për ndryshimin e vendndodhjes.
- b. Genplanin, planimetrinë e mjedisit mbi 50 m² (15 m², agjencia), të lëshuar nga arkitekt, inxhinier, i licencuar.
- c. Plan vendosjen, të lëshuar nga një arkitekt, inxhinier i licencuar, ku:
 - ✓ distanca/largësia e farmacisë/agjencisë të jetë mbi 150 metra (rrugë këmbësore), nga farmacitë apo agjencitë ekzistuese me kontratë.
 - ✓ distanca/largësia e farmacisë të jetë, mbi 20 metra nga kufiri i jashtëm i institucionit shëndetësor publik (*nuk aplikohet për agjencitë farmaceutike*).

9.1. Drejtoria Rajonale, të përcjellë, kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Fondit dhe pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve të mësipërme nga ana e Komisionit përkatës të Fondit, Drejtoria Rajonale vazhdon ose jo marrëdhëniet kontratuale me subjektin farmaceutik.

10. Në të gjitha rastet, që farmacitë, agjencitë farmaceutike, kërkojnë të rilidhin ose lidhin kontratë për vitin 2021, duhet të dorëzojnë:

- a. Vërtetimin, nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë që subjekti farmaceutik dhe pronari nuk është në hetim nga prokuroria.
- b. Dëshmi penaliteti për pronarin dhe drejtuesin teknik.

11. Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike, që rilidhin kontratë, dorëzojnë (vetëdeklarojnë) inventarin e barnave apo edhe të barnave të skaduara (në rastet kur kanë), të printuar nga programi, e-Rx.

- ✓ Çdo fletë inventari, të jetë e firmosur, nga pronari/administratori ose drejtuesi teknik, dhe e vulosur nga, farmacia/agjencia farmaceutike.
- ✓ Në fletën e fundit të inventarit të gjendjes fizike, të plotësohen elementët e recetës së fundit të ekzekutuar me rimbursim: *numri, data e recetës, kategoria e pacientit*.
- ✓ Në fletën e fundit të inventarit të gjendjes fizike, të plotësohen elementët e faturës së fundit të farmacisë: *numri, data, emri importuesit/shpërndarësit farmaceutik*, të

cilat duhet të jenë të bëra, hyrje nga farmacia dhe të regjistruara në regjistrin përkatës.

- ✓ Inventari i barnave të printohet në dy kopje, nga të cilat njëra kopje të dërgohet pranë Drejtorisë Rajonale, dhe kopja tjetër të mbahet/ruhet në farmaci/agjenci farmaceutike.
- ✓ Inventari, të dorëzohet i printuar dhe në mënyrë elektronike.

12. Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike që lidhin kontratë për herë të parë ose pas një periudhë ndërprerjeje, të dorëzojnë kopje të faturave hyrëse, të cilat të justifikojnë gjendjen fizike, të barnave të inventarit të dorëzuar.

13. Farmacia/Agjencia e cila lidh kontratë për herë të parë ose pas një periudhë ndërprerjeje, duhet të ketë, jo më pak se 60% të barnave alternativë e parë e listës së barnave që rimbursohen, në sasi të tillë jo më pak se mjekimi mujor, sipas protokollit.

14. Drejtoria Rajonale, nuk lidh kontratë me agjencitë farmaceutike në qytet apo fshat ku ka farmaci të kontraktuar.

15. Drejtoria Rajonale, nuk lidh kontratë me farmacitë/agjencitë farmaceutike të cilat janë në hetim nga organi i akuzës, për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate deri në përfundimin e plotë të hetimeve dhe zbardhjes së vendimit.

16. Drejtoria Rajonale nuk lidh kontratë me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike nëse:

- a. në ambientet e farmacisë/agjencisë ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik.
- b. ambientet e farmacisë/agjencisë nuk janë të ndara nga ambientet e tjera private ose familjare.

17. Komisioni për miratimin e lidhjes së kontratave me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike që lidhin kontratë për herë të parë me Fondin, i ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i FOND-it, verifikon kriteret a, b, c, g, h, sipas pikës 8 të këtij udhëzimi dhe bën propozimin për vazhdimin ose jo të procedurës për lidhjen e kontratës.

18. Drejtori i Drejtorisë Rajonale për lidhjen e kontratave, ngarkohet të ngrejë një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtarë, në përbërje të të cilit të ketë, farmacist dhe jurist (në ato drejtori që kanë jurist në organikë).

KOMISIONI VLERËSUES PËR LIDHJEN E KONTRATAVE

Komisioni vlerësues për lidhjen e kontratave, ngarkohet të veprojë si më poshtë vijon:

- a. Për farmacitë, të cilat kërkojnë me anë të kërkesës së tyre me shkrim, të rilidhin kontratë:

- ✓ të verifikojë, largësinë 20 metra të farmacisë në relacion me institucionin shëndetësor publik. Për të gjitha ato, subjekte, të cilat, nuk plotësojnë këtë kriter nuk u rilidhet kontrata.
 - ✓ të verifikojnë, formularin e vetëdeklarimit dhe të identifikojnë nëse ka ndryshime nga kontraktimi i mëparshëm, nëse ka, atëherë të kërkojnë plotësimin e tyre me kopje të justifikuar për dokumentacionit për ndryshimin.
- b. Për farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat kërkojnë me anë të kërkesës së tyre me shkrim, të lidhin kontratë pas një periudhe ndërprerjeje, më pak se 1 (një) vit:**
- ✓ të verifikojë, largësinë 20 metra të farmacisë në relacion me institucionin shëndetësor publik. Për të gjitha ato, subjekte, të cilat, nuk plotësojnë këtë kriter nuk u lidhet kontrata. *(nuk aplikohet për agjencitë farmaceutike).*
 - ✓ të verifikojë, me sondazh, saktësinë e inventarit të gjendjes fizike të jo më pak se 20 barnave, të cilat kanë, konsumin dhe vlerën më të lartë të rimbursimit, sipas inventarit të dorëzuar nga subjekti. Rezultati, ti bashkëlidhet dokumentacionit bazë.
- c. Për farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat kërkojnë me anë të kërkesës së tyre me shkrim, të lidhin kontratë për herë të parë, pas miratimit nga Fondi:**
- ✓ të shqyrtojë, dokumentacionin e paraqitur nga subjektet.
 - ✓ të verifikojë, me sondazh, saktësinë e inventarit të gjendjes fizike të jo më pak se 20 barnave, të cilat kanë, konsumin dhe vlerën më të lartë të rimbursimit, sipas inventarit të paraqitur. Rezultati, ti bashkëlidhet dokumentacionit bazë.

Ngarkohet, Komisioni Vlerësues, në të tre rastet e sipërcituara (*pikat a, b dhe c*), të mbajë procesverbalin në lidhje me zbatueshmërinë e kritereve, për lidhjen/rilidhjen e kontratës me subjektin e interesuar.

Komisioni Vlerësues, ngarkohet të paraqesë të gjithë dokumentacionin justifikues, pranë titullarit të Drejtorisë Rajonale, i cili merr vendimin për lidhjen ose jo të kontratës.

19. Ngarkohet, Drejtoria Rajonale, të lidhë kontratën me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat kanë plotësuar kriteret përkatëse, brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës së tyre, me dokumentacionin përkatës.

20. Ngarkohet, Drejtoria Rajonale, të njoftojë me shkrim, subjektin e interesuar, në rastet e moslidhjes së kontratës, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

21. Ngarkohet, Drejtoria Rajonale, të nënshkruajë në dy kopje, kontratën tip me farmacitë dhe agjencitë farmaceutike. Njëra kopje, të mbahet nga Drejtoria Rajonale dhe tjetra të mbahet nga farmacia/agjencia përkatëse, të cilat të jenë të firmosura dhe të vulosura.

22. Çdo farmaci/agjenci farmaceutike e kontraktuar, nëse gjatë vitit në vazhdim do të ketë ndryshim të të dhënave të vetëdeklaruarra është e detyruar të plotësojë formularin tip të përditësimit të vetëdeklarimit duke e shoqëruar atë me kopje të dokumentit përkatës që vërteton ndryshimin.

23. Për çdo ndryshim, të njërit nga kriteret:

- a. Licencë e aktivitetit
- b. Pronar i aktivitetit
- c. NIPT/NUIS
- d. Drejtues teknik

DRF përkatëse dhe subjekti farmaceutik nënshkruajnë shtojcë kontrate.

24. Sektori i rimbursimit në Drejtorisë Rajonale ngarkohet të bëjë regjistrimin, përditësimin e të dhënave të subjekteve farmaceutike të kontraktuar në regjistrin elektronik dhe në sistem, bazuar në dokumentacionin e Komisionit Vlerësues.

25. Drejtoria Rajonale, pas lidhjes së kontratës për herë të parë, me farmacinë/agjencinë farmaceutike, ngarkohet të pajisë, subjektin me "Posterin" e Fondit, që mban mbishkrimin "Me kontratë me FSDKSH". Farmacia/agjencia farmaceutike është e detyruar, të ketë këtë poster të afishuar në pjesën e përparme të hyrjes gjatë gjithë kohës që kontrata është e vlefshme. Në momentin e shkëputjes së kontratës, Drejtoria Rajonale, ngarkohet të largojë/heqë posterin nga ambjenti i subjektit.

26. Ngarkohet, Drejtoria Rajonale, të dërgojë pranë Drejtorisë së Rimbursimit të Fond-it, brenda 5 (pesë) ditëve, të dhënat e plota mbi subjektet farmaceutike të kontraktuar.

Ngarkohet, Drejtoria Rajonale të marrë të gjitha masat, për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

DREJTORI I PËRGJITSHËM
(I komanduar)

Albana Çela

